



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13468 Prot

Lezhë, më 29/07/2022

VENDIM

Nr. 84, Datë 28.07.2022

Për

Miratimin e ndihmës financiare për shtetasit Gj.Ç dhe T.N nga fondi i emergjencës.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", të ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" dhe kërkesës së paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesat e Znj.Gj. Ç., banore në Sheëngjin, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë dhe Z.T. N., banor në Piraj, Njësia Administrative Blinisht, Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e ndihmës financiare për Znj.Gjyste Çepele me Nr.ID.F26104006V, banore në Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjin Bashkia Lezhë nga fondi i emergjences në shumën prej 85,573 lekë.
2. Miratimin e ndihmës financiare për Z.Tom Ndoci me Nr.ID.G01219013C, banor në Piraj, Njësia Administrative Blinisht, Bashkia Lezhë nga fondi i emergjences në shumën prej 99,573 lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Emergjencave Civile.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI



Kesh



Nr. 13468/Prot
Dt. 8.8.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË MBROJTJES CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 549/18 Prot.

Lezhë, më 08.08.2022

Lënda: Konfirmim vendimi.

KËSHILLIT TË BASHKISË

KRYETARIT TË BASHKISË

LEZHË

Bazuar në ligjin nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2/b; në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjes vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, 1.1, gërma 'b', neni 54, gërma 'n'; neni 55; në ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41, si dhe në VKM nr.329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të Vendimit nr.84, datë 28.07.2022, "Për miratimin e ndihmës financiare mbi dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesat e shtetasve Gjyste Çepele, njësia administrative Shëngjin, dhe shtetasit Tom Ndoci, banor në fshatin Piraj, njësia administrative Blinisht, bashkia Lezhë".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

